



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat e) f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafët 1.5 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nenit 3 paragrafi 5 dhe 17 paragrafi 1.5 të Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0030667/22 për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Vendimit komunal nr.prot.01-401/01-0065086/24 për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027, në Kërkesë të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave KRM "Pastrimi" Sh.A. nr.prot.02-400/04-0012498/25 datë 27.02.2025, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2025, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE – KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Neni 1

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumë 60,000.00€ për subvencionimin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave - KRM "Pastrimi" Sh.A, shumë e cila ekzekutohet në dy pjesë, dhe atë 30,000.00€ në vitin 2025 dhe 30,000.00€ në vitin 2026.

Neni 2

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria e subvencioneve, *(programi buxhetor 48005-Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik)* dhe ka për qëllim dhënien e ndihmës për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të Ndërmarrjes, me theks për investime në përmirësimin e gjendjes së makinerive, përmbushjen e obligimeve / borxheve të Kompanisë si dhe çështjeve dhe vështirësive tjera që përballlet kjo Kompani.

Neni 3

Shuma e mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi bartet nga Komuna në xhirollogarinë bankare të KRM "Pastrimi" Sh.A.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 5

Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021 si dhe Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave.

Nr.Prot. 01-400/04-0015030/25
Podujevë, datë; 13 mars 2025



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha